

# KONTRATË PËR LËSHIMIN E INSTRUMENTIT FINANCIAR

Kjo kontratë midis palëve:

Shoqëria e Sigurimeve SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.A, person juridik i regjistruar me Vendimin e Gjykatës Nr.20863 dt. 22/02/1999, K. Fiskal 3708093 me adresë; Qendra e Biznesit SIGAL, Blv. "Zogu I", Nr.1, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Avni PONARI - Drejtor i Përgjithshëm, i datëlindjes 28/07/1957, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 024396313, që këtu më poshtë do të quhet "SIGAL": Dhe Shoqëria e përcaktuar në garancinë bashkangjitur që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që këtu më poshtë do të quhet "Debitori Kryesor".

**Objekti i Kontratës** - Sigurimi i detyrimit që mund të lind në të ardhmën nga konfiskimi i Garancisë që SIGAL ka lëshuar apo do të lëshoj për Debitorin Kryesor dhe në favor të personave të tretë, siç dhe përcaktohet në këtë kontratë.

**Baza Ligjore** - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

**Vlefshmëria** - Kontrata zgjat deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së Certifikatës së Garancisë ose në rast zbatimi nga SIGAL të detyrimit përcaktuar në Garanci, deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve që lindin për Debitorin Kryesor, siç dhe janë përcaktuar në këtë Kontratë. Palët sa mësipër bien dakort si vijon:

**Neni 1** - SIGAL ka lëshuar për "Debitorin Kryesor" një Certifikatë Garancie sipas të dhënave në garancinë bashkangjitur, në mbulim të përgjegjësisë së "Debitorit Kryesor" ndaj "Përfituesit të Garancisë"

**Neni 2** - "Debitori Kryesor" pranon përbajtjen e Certifikatës/ve të Garancisë dhe detyrohet të paguaj primin përkatës të sigurimit si dhe të përdorë Certifikatën e Garancisë për qëllimin e mirë për të cilin ajo/ato lëshohet duke ju përbajtur moralisht dhe ligjërisht të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i saj/tyre.

**Neni 3** - SIGAL ka të drejtën e rimbursimit nga Debitori Kryesor dhe/ose Dorëzanësi të çdo shumë brenda vlerës së garantuar mësipër (neni 1) + interesa, kamat vonësa apo çdo shpenzim për rimbursimin e çdo shume që ai bëhet përgjegjës të paguaj në përputhje me detyrimet e parashikuara në Certifikatën e Garancisë.

**Neni 4** - Në rast se Përfituesi paraqet kërkesë për konfiskim Garancie, Debitori Kryesor brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës do t'i paguaj SIGAL, ose do të vendos si kesh kolateral në emër të tij, çdo shumë që SIGAL bëhet përgjegjës të paguaj sipas përcaktimit në pikën 3 mësipër pavarësisht nëse SIGAL ka kryer apo jo pagesë sipas detyrimeve të parashikuara në Certifikatën e Garancisë.

**Neni 5** - Dorëzanësi detyrohet t'i përgjigjet SIGAL me kërkesën e parë me shkrim, pavarësisht nga aftësia paguese e Debitorit Kryesor, për çdo shumë që sipas Certifikatës së Garancisë, SIGAL bëhet përgjegjës të paguaj.

**Neni 6** - Duke paguar shumën apo çdo shumë brenda kufirit të shumës së përcaktuar në këtë Kontratë, SIGAL sh.a. do t'i kalojnë të drejtat e Përfituesit lidhur me shumën e garantuar sipas Certifikatës së Garancisë, duke përfshirë këtu çdo mjet sigurimi dhe aksesorë të tjerë që sigurojnë pagimin e kësaj shumë. Asnjë autoritet ose person nuk do të ndërmarrë ndonjë veprim për të paragjykuar këtë.

**Neni 7** -Të gjithë detyrimet e çfarëdo natyre që SIGAL duhet të përballojë për kthimin e shumës së garancisë së paguar janë në ngarkim të Debitorit Kryesor.

**Neni 8** - Pjesë integrale e kësaj Kontrate është Certifikata e Garancisë objekti i kësaj Kontratë.

**Neni 9** -Shtesa ose ndryshime të kësaj Kontrate bëhen me shkrim.

**Neni 10** -Për çfarë nuk është përcaktuar shprehimisht në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e K.C, Pjesa IV mbi Detyrimet dhe Pjesa V Dorëzania.

**Neni 11**- Në rast se ndonjë apo më shumë nga dispozitat e kësaj Kontratë dhe akteve të tjera të cilave kjo Kontratë i referohet shpallen apo mund të konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme apo të pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të ndikohet. Palët në mirëbesim do të negociojnë për të zëvendësuar dipozitat e kontestueshme me dipozita të vlefshme më efekte riparuese të përafërta me qëllimin e palëve të shprehur sipas kësaj Kontrate.

**Neni 12** - Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve si rezultat i kësaj Kontratë zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë.

**Neni 13** - Kjo Kontratë lidhet sipas datës të përcaktuar në garanci, u përpilua me vullnetin e lirë të palëve dhe firmoset pa vërejtje nga palët.

Unë deklaroj se me vullnetin tim të plotë dhe të lirë i kam dhënë Shoqërisë së Sigurimit të dhënat e mia personale. Unë autorizoj Shoqërinë e Sigurimit që në përputhje me legjislacionin në fuqi, të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal, i cili nevojitet për administrimin e kontratës të sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të Siguruarit dhe Përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, si dhe transferimin e të dhënave personale të të tretëve për qëllime të sigurimit apo biznesi në përputhje me Ligjin Nr.9887, date 10/03/2008 – "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Unë deklaroj se të gjitha të dhënat që ndodhen në aplikimin për sigurimin dhe cdo informacion tjetër i dhene Shoqërisë së Sigurimit, në funksion të lidhjes së Kontratës së Sigurimit nga unë, janë të vërteta dhe të sakta dhe jam në dijeni dhe i vetëdijshëm për pasojat që vijnë në rastin e deklarimeve të pasakta apo pavërteta.

Unë deklaroj se përpara nënshkrimit të kësaj kontrate jam njohur me të gjitha kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të cilat aplikohen në lidhje me këtë kontratë sigurimi dhe jam dakord me to.

**NËNSHKRUAR NGA:**

**SIGURUESI**  
**AVNI PONARI**  
**Administrator i Përgjithshëm**



**DEBITORI KRYESOR**

(Emri, mbiemri, firma, Vula)